

Hartëzim i gjendjes së objekteve për sport nëpër komunat



Kingdom of the Netherlands



30 YEARS
DIPLOMATIC RELATIONS
WE SHINE TOGETHER



Hartëzim i gjendjes së objekteve për sport nëpër komunat

Shkup, 2023

Hartëzim i gjendjes së objekteve për sport nëpër komunat

Botues:

Qendra për Komunikime Qytetare

Përktheu nga gjuha maqedonase në
gjuhën shqipe:

Agon Ismaili

Graphic design:

Relativ

Botim elektronik:

(Hartëzim i gjendjes me objektet për
sport nëpër komunat)

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

796.02:005.5]:352(497.7)(047.31)

725.85:005.5]:352(497.7)(047.31)

МАПИРАЊЕ на состојбата со објектите за спорт во општините [Електронски извор] / [përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Agon Ismaili ; translation from Macedonian to English Magdalena Simionska]. - Текст во пдф формат, содржи 20, 20, 20 стр. - Скопје :

Центар за граѓански комуникаци = Skopje : Center for civil communications ; Shkup : Qendra për komunikime qytetare, 2023

Начин на пристапување (URL):

<https://www.ccc.org.mk/images/stories/mapiranje-sport.pdf>. - Напореден текст на мак., англ. и алб. јазик. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 07.09.2023 год. - Содржи и: Hartëzim i gjendjes së objekteve për sport nëpër komunat ; Mapping the situation with the sports facilities in the municipalities ; Анекс = Annex = Aneksi

ISBN 978-608-4974-20-8

a) Спортски објекти -- Управување -- Локална самоуправа -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 61478405



Kingdom of the Netherlands

Hulumtimi është përgatitur në kuadër të projektit "Mbrotje nga korrupsioni" me asistencë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, ndërsa është zbatuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën nga 1 nëntor 2021 deri më 31 tetor 2024.


PËRMBAJTJA


6	Konstatimet kryesore
8	Synimi i hulumtimit
9	Menaxhimi me objektet për sport nga ana e vetëqeverisjeve lokale
14	Menaxhimi me objektet për sport nga ana e shkollave
18	Rekomandimet
19	ANEKSI 1: Listë e objekteve për sport të cilat i kanë në dispozicion komunat e monitoruara

KONSTATIMET KRYESORE

- Komunat dhe shkollat i japin në përdorim objektet për sport në bazë të kërkesave të pranuara nga klubet sportive, nga shoqatat e qytetarëve dhe qytetarët e interesuar, ndërsa jo në procedura transparente me shpallje paraprake të thirrjeve publike dhe me kushte, kritere e çmime qartë të përcaktuara. Këtë e zbulon hulumtimi i zbatuar në komunat Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip. Praktika e këtillë lë hapësirë për veprim në mënyrë vullnetare dhe mundësi për përdorim të parregulluar dhe joadekuat të objekteve për sport.
- Tetë komunat, të cilat ishin subjekte të monitorimit kanë gjithsej 42 objekte për sport, ndërsa shkollat në këto komuna në dispozicion kanë 124 objekte.
- Nga gjithsej 42 objektet për sport në komunat Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip, 7 prej tyre nuk janë në përdorim për shkak të dëmtimeve dhe vjetritimit, ndërsa me 12 objekte sportive (me lokacion në Manastir, në Strumicë, Tetovë dhe Çair) as nuk menaxhojnë autoritetet lokale, por ato janë fituar për përdorim të përhershëm, pasi Ndërmarrja publike për Ekonomizim me Objekte për Sport në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka lidhur marrëveshje me subjekte juridike për përdorimin e tyre.
- Tre nga tetë komunat (Kumanovë, Negotinë dhe Çair) kompetencat për menaxhim me objektet për sport ua kanë dorëzuar ndërmarrjeve publike lokale.
- Objektet komunale për sport, vetëqeverisjet lokale kryesisht ua ndajnë për përdorim klubeve lokale sportive pa kompensim. Të ardhura nga dhënia e objekteve realizon vetëm komuna e Tetovës dhe tërthorazi, komuna e Kumanovës dhe komuna e Negotinës, ku objektet sportive janë dhënë nën menaxhim të ndërmarrjeve publike lokale.
- Në përdorim jepen vetëm 46 nga 124 objekte për sport të cilat i kanë në dispozicion shkollat, përkatësisht vetëm 36 % të objekteve. Shkollat i lëshojnë në përdorim objektet sportive pas pëlqimit të dhënë nga vetëqeverisjet lokale, mirëpo pa shpallje paraprake të thirrjeve publike për të gjitha palët e interesuara, me përjashtim të dy shkollave.
- Për dallim prej komunave, të gjitha shkollat që i japin në përdorim sallat dhe objektet e tyre sportive arkëtojnë kompensim për atë shërbim. Gjatë kësaj, është vërejtur dallim i madh në çmimet me të cilat jepen objektet sportive nga ana e shkollave. Çmimet për përdorim të sallave sportive të shkollave lëvizin nga 200 deri 1.300 denarë për një orë.

- Dhënia në përdorim i vetëm një të tretës së objekteve të cilat i kanë në dispozicion vetëqeverisjet lokale dhe shkollat sugjeron në shfrytëzimin e tyre të pamjaftueshëm. Njëkohësisht, kjo flet për dobësitë në menaxhimin dhe pamundësimin që objektet e sportit të përdoren nga një pjesë sa më e madhe e popullatës lokale dhe të gjenerojnë të ardhura të cilat më pas do të investohen për mirëmbajtjen e rregullt dhe modernizimin e tyre.
- Vështruar në lidhje me vetëqeverisjet lokale, vetëm komuna e Shtipit ka miratuar Rregullore për përcaktimin e kushteve dhe për mënyrën e përdorimit të terreneve të sportit dhe objekteve të sportit, ndërsa nga ana e shkollave, ky numër është më i lartë, mirëpo kjo nuk ka pasur ndikim të konsiderueshëm në drejtim të rritjes së transparencës së procesit të dhënies në përdorim të objekteve.
- Kohëzgjatja e procesit të sigurimit të informacioneve për të gjitha objektet për sport dhe të informacioneve relevante për përdorimin e tyre në komunat e synuara ishte 7 muaj. Vështirësitë në sigurimin e të dhënave tregojnë që disa vetëqeverisje lokale nuk mbajnë evidencë të azhurnuar dhe kanë nivel të ulët të llogaridhënies për pronën të cilën e kanë në dispozicion. Saktësia e të dhënave në këtë hulumtim është përgjegjësi e komunave.
-





SYNIMI I HULUMTIMIT

Strategjia nacionale për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2021 – 2025, e përpiluar nga Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit dhe e miratuar nga Kuvendi i RMV-së, e përfshin sportin si një nga sektorët e ekspozuar ndaj korrupsionit. Ky sektor për herë të parë trajtohet nga aspekti i parandalimit të korrupsionit. Si qëllim parësor në strategjinë, në sektorin sport është cekur miratimi i strategjisë për objektet për sport në pronësi shtetërore, me të cilën do të vendoset koncept i qartë për këto objekte. Si domosdoshmëri përmendet edhe identifikimi i gjendjes aktuale me objektet për sport dhe revidimi i marrëveshjeve për përdorimin e tyre, që paraqet edhe një nga synimet e këtij hulumtimi.

Strategjia e identifikon edhe problemin lidhur me mbikëqyrjen inspektuese në sport dhe nevojën për vendosje të mbikëqyrjes efikase inspektuese në sport dhe në objektet sportive, si dhe edukimin për integritet dhe etikë të federatave të sportit, klubeve dhe administratave të tyre. Sporti si sektor trajtohet në strategjinë për shkak të rrezikut nga korrupsioni në sferën e menaxhimit dhe disponimit me objektet sportive në pronësi të RMV-së dhe të njësisë të vetëqeverisjes lokale, por edhe në sferën e veprimtarisë së sportit, e cila realizohet nëpërmjet federatave të sportit dhe klubeve sportive si anëtarë të tyre.

Duke i pasur parasysh investimet e mëdha të shtetit në objektet sportive dhe rëndësinë e tyre për veprimtarinë sportive, menaxhimi me atë pronë paraqet një fushë e cila luan rol serioz në interesin publik. Kjo e imponon nevojën edhe për rregullim optimal normativ të raporteve në aspekt të pronësisë, disponimit me dhe përdorimit të objekteve sportive, që dukshëm mungon duke i marrë parasysh konstatimet nga ky hulumtim.

Me qëllim që të hartëzohet gjendja në këtë sektor, Qendra për Komunikime Qytetare, së bashku me organizatat joqeveritare të përfshira në zbatimin e projektit “Mbrotje nga korrupsioni” (Qendra Kulturore Rinore Manastir, Koalicioni rural Kërçovë, Qendra për dialog ndërkulturor Kumanovë, Shoqëria ekologjike Villa Zora Veles, Shoqata për hulumtime dhe analiza - NOVUS Strumicë, Shoqata Multikultura Tetovë, Shoqata e qytetarëve ZIP INSTITUT për politika dhe qeverisje të mirë Shkup, Shoqata EHO – organizatë edukuese humanitare), ka dërguar kërkesa identike për informacione deri tek tetë komunat e përfshira në këtë projekt (komuna Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip), si dhe deri te gjithsej 107 shkollat nga këto komuna (79 shkolla fillore dhe 28 shkolla të mesme). Janë kërkuar informacionet në vijim: listë e objekteve sportive që janë në pronësi të tyre ose me të cilat ato menaxhojnë, listë e objekteve sportive të cilat aktualisht u janë dhënë në përdorim personave juridikë dhe fizik dhe me çfarë kushte (emërtimi i shfrytëzuesit të objektit; afati i dhënies në përdorim; lartësia e kompensimit; dedikimi i përdorimit të objekteve), marrëveshjet për përdorim të objekteve sportive, informacione për procedurën sipas të cilës janë ndarë marrëveshjet për përdorim të objekteve sportive me përshkrim të procedurës, kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së shfrytëzuesve të objekteve për sport, akt intern me të cilin është rregulluar procesi i ndarjes së objekteve sportive për përdorim, listë e çmimeve/tarifore për përdorim të objekteve sportive, vendi (gazetë zyrtare, ueb-faqe, gazetë lokale etj.) dhe përmbajtja e thirrjeve të shpallura për dhënien e objekteve sportive në përdorim si dhe informacionin kush i përdor dhe për çfarë dedikimi objektet sportive të cilat nuk u janë dhënë në përdorim personave juridikë dhe fizik.

MENAXHIMI ME OBJEKTET PËR SPORT NGA ANA E VETËQEVERISJEVE LOKALE

- » Tetë vetëqeverisjet lokale (Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip) kanë në pronësi ose menaxhojnë me gjithsej 42 objekte për sport. Objektet, në pjesën më të madhe prej tyre janë të klasifikuara si stadione, 15 në numër. Krahas tyre, vetëqeverisjet lokale kanë 10 salla, nga tre terrene për tenis dhe terrene futbollit, tre pishina, dy terrene sportive me më shumë dedikime, katër komplekse sportive, një terren për hendboll dhe një poligon urban për qitje. Megjithatë, vetëm dhjetë nga këto 42 objekte për sport në këto 8 komuna momentalisht u janë dhënë në përdorim personave juridikë dhe fizik.

Më së shumti objekte për sport në territor ka **Komuna e Kumanovës**, gjithsej tetë edhe atë Pishinë të çelur dhe të mbyllur të qytetit, Stadium të qytetit, terren për tenis "23 Tetori", terren për tenis në shëtitoren e qytetit, qendrën rekreative sportive "Pelince", Qendrën sportive – sallë sportive, kompleksi sportiv "Sokollana" dhe kompleksin "Poligoni urban për qitje".

Me Vendimin për transferim të kompetencës – menaxhim dhe mirëmbajtje të objekteve sportive dhe qendrave rekreative sportive nga viti 2022, Komuna e Kumanovës për shtatë objekte sportive ia ka transferuar kompetencën Ndërmarrjes Publike "Kumanovo parking". Vetëm objekti në Pelince nga viti 2011 është nën kompetencë të NP "Pastërti dhe gjelbërim", mirëpo ky objekt nuk është në funksion.

Nga të gjitha shtatë objektet sportive, NP "Kumanovo Parking" jep në përdorim vetëm dy, edhe atë pishinën e qytetit dhe terrenet për tenis. Ndërmarrja ka lidhur marrëveshje me gjashtë klube noti dhe me një klub tenisi për vitin rrjedhës 2023. Gjatë kësaj, stadiumi i qytetit, megjithëse është në funksion, nuk është dhënë në përdorim, ndërsa qendra sportive Salla e sportit "Sokollana" dhe kompleksi "Poligoni urban i qitjes" as nuk janë në funksion.

Ndërmarrja publike "Kumanovo Parking", e cila në emër të Komunës së Kumanovës menaxhon me objektet për sport, nuk ka të miratuar akt intern¹ me të cilin do të ishte e rregulluar procedura për përzgjedhjen e shfrytëzuesve/qiramarrësve të objekteve për sport. Ndërmarrja publike nuk shpall thirrje publike për dhënien e objekteve për përdorim. Nga NP "Kumanovo Parking" sqarojnë se të gjitha informacionet e nevojshme janë publikuar në derën e hyrjes së Pishinës së qytetit dhe në objektet tjera, ndërsa për përdorim të objekteve, kërkesa dërgojnë të gjitha subjektet e interesuara.

E radhës në listë, për nga numri i objekteve për sport në territorin e saj është **Komuna e Tetovës**, me shtatë objekte sportive. Bëhet fjalë për stadiumin kryesor të qytetit dhe stadiumin plotësues në afërsi të stadiumit të qytetit, për stadiumin me bar artificial në Qendrën sportive Tetovë, për pishinën e qytetit si dhe terrenet sportive në lagjet Teqe, Reçica e Madhe dhe Saraqinë.

¹ Me akt intern nënkuptohet procedura, politika ose ndonjë lloj dokumenti tjetër me të cilin institucioni e rregullon çështjen në fjalë.

Stadiumi kryesor i qytetit dhe stadiumi plotësues në afërsi të stadiumit të qytetit i janë dhënë me koncesion firmës “Ekolog”. Së këtejmi, nga objektet me të cilat de fakto menaxhon komuna e Tetovës, në përdorim jepet vetëm stadiumi futbollit me bar artificial te qendra sportive. Stadiumi u jepet në përdorim në nivel vjetor tre klubeve të futbollit: “Shkendija”, “Teteks” dhe “Ljuboten” dhe për secilin prej tyre komuna lëshon faturë. Komuna e Tetovës me klubin e futbollit “Shkendija” ka marrëveshje me të cilën klubi e përdor stadiumin me bar artificial në termine saktë të përcaktuara dhe paguan kompensim për përdorim në shumë prej 12.000 euro në vit. Klubet e futbollit “Teteks” dhe “Ljuboten” e përdorin stadiumin me bar artificial te Qendra sportive për futboll dhe kanë marrëveshje aktive për gjithë vitin 2023, për të cilin paguajnë kompensim në pajtim me vendimin për dhënie të terminëve dhe sipas listës së çmimeve të miratuar nga ana e Komunës së Tetovës si dhe 18 % TVSH. Në pajtim me vendimin të cilin e ka miratuar Këshilli i Komunës së Tetovës për dhënie në përdorim të stadiumit, për 1 orë stërvitje paguhet 750 denarë, nëse stërvitja është me ndriçim 1.200 denarë, për ndeshje zyrtare dhe miqësore nga 3.000 denarë, por nëse për mirëmbajtjen e tyre nevojitet ndriçim, atëherë çmimi është 5.000 denarë për ndeshje. Me terrenet e sportit në lagjet Teqe, Reçica e Madhe dhe Saraqinë, siç thonë nga Komuna e Tetovës, disponon popullata lokale.

Komuna e Tetovës është një nga komunat e rralla e cila gjeneron të ardhura nga dhënia në përdorim të objekteve për sport. Mirëpo, në procesin e dhënies në përdorim, komuna nuk disponon me akt intern me të cilin, do të ishte e rregulluar procedura për përzgjedhjen e shfrytëzuesve/qiramarrësve të objekteve për sport, e as nuk ekziston praktikë për shpallje publike të thirrjeve për dhënien në përdorim të objekteve për sport me kushte dhe kritere të qarta.

E radhës në listën për nga numri i objekteve për sport në territorin e vet është **Komuna e Manastirit** me gjashtë objekte. Megjithatë, komuna ka mundësi të menaxhojë dhe të përdor vetëm dy prej gjashtë objekteve, edhe atë sallën sportive “Boro Çurlevski” dhe stadiumin e futbollit “Petar Milloshevski”. Në anën tjetër, me objektet Pishinë e çelur dhe restorant, Terrenet e tenisit, terrenet për hendboll dhe ShEF “Partizan” menaxhon Ndërmarrja Publike për Ekonomizim me Objekte për Sport në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ndërmarrja Publike Shtetërore ka lidhur marrëveshje për përdorim edhe atë me SIU Manastir për Pishinën e Çelur dhe Restorant, me ShSGj “Partizan” për terrenet e tenisit, me “Mega sport” Manastir për terrenet e hendbollit dhe me “Xhoker Turist” Manastir për ShEF “Partizan”.

Rezulton që komuna e Manastirit aktualisht menaxhon vetëm me dy objekte sportive, edhe atë me sallën e sportit “Boro Çurlevski” dhe me stadiumin e futbollit “Petar Milloshevski” dhe këto objekte ua lëshon klubeve sportive në Manastir në pajtim me Listën e çmimeve për përdorim të objekteve sportive në rajonin e Komunës së Manastirit. Njëkohësisht, këshilli i Komunës së Manastirit ka miratuar vendim sipas të cilit klubet sportive në të cilat komuna ka strukturë kapitale janë të çliruar nga pagesa e kompensimit. Në këtë moment, Komuna e Manastirit nuk ka marrëveshje me persona juridikë dhe fizik për të cilët paguhet kompensim për përdorim të objekteve për sport në komunë, duke e pasur parasysh që objektet i përdorin vetëm klube në të cilat komuna ka strukturë kapitale, e ato janë klubi i basketbollit “Pelister” SHA Manastir, klubi i hendbollit “Eurofarm Pelister 2” dhe klubi i futbollit “Pelister”.

Komuna e Manastirit nuk ka akt intern të miratuar me të cilin do të ishte e rregulluar procedura për përzgjedhjen e shfrytëzuesve/qiramarrësve të objekteve për sport. Sallën dhe stadiumin, me të cilët menaxhon komuna, e përdorin klube në të cilat vetë komuna posedon strukturë kapitale. Nga këtu, komuna nuk gjeneron të ardhura nga dhënia në përdorim të objekteve për sport dhe nuk ka obligim për të shpallur thirrje publike për dhënien e objekteve në përdorim or leasing them.

Komuna e Kërçovës disponon me gjashtë objekte për sport, edhe atë salla sportive "Jançicë", salla sportive "Hristo Uzunov" në Ivanidoll, salla sportive "Sokollana", stadiumi i qytetit, stadiumi "Vëllazërimi" dhe stadiumi në Zajaz. Gjatë kësaj, nga tre salla sportive, dy janë funksionale, edhe atë sallat sportive "Hristo Uzunov" dhe "Sokollana", ndërsa salla sportive "Jançicë", në periudhën e realizimit të këtij hulumtimi, ka qenë në proces të rinovimit. Secili nga tre stadiumet që janë në pronësi të komunës janë funksionale dhe në përdorim. Stadiumin e qytetit e përdorin klubet e futbollit "Napredok" dhe "Zajaz", stadiumin "Vëllazërimi" e përdor klubi i futbollit "Vëllazërimi 1977", ndërsa stadiumin në Zajaz e përdor gjithashtu klubi i futbollit "Vëllazërimi 1977".

Sipas përgjigjes së fituar nga Komuna e Kërçovës, objektet për sport mund t'i përdorin klubet sportive, shoqatat e qytetarëve dhe qytetarë të interesuar, sipas nevojës, me kërkesë paraprakisht të dorëzuar nga ana e tyre dhe pas pëlqimit të dhënë nga komuna, ndërsa për përdorimin e tyre nuk paguajnë kompensim.

Komuna e Kërçovës nuk ka akt intern të miratuar me të cilin do të ishte e rregulluar procedura për përzgjedhjen e shfrytëzuesve të objekteve për sport, ndërsa as nuk ka praktikë për shpallje të thirrjeve publike për dhënien e objekteve në përdorim.

E radhës në listë, për nga numri i objekteve për sport në territorin e saj është **Komuna e Strumicës**, me pesë objekte të këtilla (një terren futbollit, dy stadione dhe dy salla). Prej këtyre objekteve, komuna e Strumicës menaxhon vetëm me dy objekte, edhe atë me terrenin komunal për futboll "Filip Lazarevski" dhe me stadiumin QS (Gradsko Balldovci). Ndërsa, stadiumi "Mlladost", salla e sportit "Park" dhe salla e sportit "Partizan" i janë dhënë në përdorim Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Objekte për Sport në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë kësaj, ndërmarrja shtetërore publike për stadiumin "Mlladost" ka lidhur marrëveshje për koncesion deri në vitin 2037 me klubin e futbollit "Bellastica", për sallën e sportit "Park" marrëveshja për koncesion deri në vitin 2025 është nënshkruar me klubin e basketbollit "ABA" dhe për sallën e sportit "Partizan" marrëveshje për koncesion është lidhur me KSGJ "Partizan", mirëpo ky koncesion tani më ka skaduar.

Nga objektet me të cilat aktualisht menaxhon Komuna e Strumicës, terrenin e futbollit "Filip Lazarevski" e përdorin klubi i futbollit "Akademija Pandev", klubi i futbollit "Bellastica", klubi i futbollit "Tiverija", klubi i futbollit i femrave "Tiverija" dhe paralelja e futbollit nga shkolla e mesme në Strumicë. Të gjithë këta klube e përdorin terrenin pa kompensim edhe atë në kohë të papërcaktuar, rreptësisht për futboll. Stadiumin QS "Bllagoj Istatov" (Gradsko Balldovci) e përdor klubi i futbollit nga fshati Gradsko Balldovci, pa kompensim, mirëpo me detyrimin për rinovimin e tij.

Komuna e Strumicës nuk ka akt intern të miratuar me të cilin do të ishte e rregulluar procedura për përzgjedhjen e shfrytëzuesve të objekteve për sport. Marrëveshjet ndahen me vendim të Këshillit të komunës, pa shpallje paraprake të thirrjeve publike për dhënie në përdorim të objekteve për sport. Komuna nuk gjeneron të ardhura nga dhënia e objekteve.

Komuna e Shtipit disponon me katër objekte për sport, edhe atë me terrenin e futbollit në Bello Bërdo, terrenin e futbollit në Suitllak, terrenin e sportit me shumë dedikime në bashkësinë urbane Autokomandë dhe me terrenin e sportit me shumë dedikime në bashkësinë urbane Senjak. Lidhja e marrëveshjeve me personat juridikë dhe me personat fizik për përdorim të objekteve sportive në pronësi të komunës së Shtipit është e rregulluar me akt të posaçëm, Rregullore për përcaktimin e kushteve dhe mënyrës për shfrytëzim të terreneve sportive dhe objekteve sportive, numër 08-3229/1, e miratuar më 30 maj 2018 dhe ajo Rregullore është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren për përcaktimin e kushteve dhe mënyrës për shfrytëzim të terreneve sportive dhe objekteve sportive, numër 08-1765/1 nga 14 mars 2022.

Procedura për dhënien në shfrytëzim të terreneve sportive dhe objekteve sportive është e përfshirë në nenin 8 të rregullores si në vijim: “Për zbatim të procedurës për dhënie në përdorim të terreneve sportive dhe objekteve sportive kompetent është Seksioni i shërbimeve publike të Komunës së Shtipit. Për marrëveshjet e lidhura për përdorim të terreneve sportive dhe objekteve sportive, Seksioni i shërbimeve publike mban evidencë në formë regjistri”.

Komuna e Shtipit nuk shpall thirrje për dhënie në përdorim të objekteve për sport. Mënyra e dhënies në përdorim është e rregulluar me nenin 9 të Rregullores për përcaktimin e kushteve dhe mënyrës për përdorim të terreneve sportive dhe objekteve sportive: “Për përdorim të terreneve sportive dhe objekteve sportive, subjektet e interesuara parashtrojnë kërkesë në Seksionin e shërbimeve publike të Komunës së Shtipit.”

Terreni i futbollit në Bello Bërdo përdoret pa kompensim nga ana e shkollave rinore të pionerëve të klubit të futbollit “Bregallnica” dhe nga paralelja e Akademisë së Sportit për futboll, si dhe nga Federata e Futbollit e Maqedonisë, Shkup, ndërsa terreni i futbollit Suitllak, me vendim të Këshillit, i është dhënë në përdorim klubit të futbollit “Bregallnica”. Në periudhën e zbatimit të këtij hulumtimi, terrenet me më shumë dedikime nuk janë dhënë në përdorim. Përndryshe,

në pajtim me Rregulloren, personat e tjerë të interesuar për përdorim të terreneve të futbollit paguajnë nga 1.500 denarë për një orë, kurse për terrenet me më shumë dedikime arkëtohen nga 600 denarë për një orë.

Komuna e Shtipit ka Rregullore për përcaktimin e kushteve dhe mënyrës për përdorim të terreneve sportive dhe objekteve sportive, por në Rregulloren nuk është paraparë obligim për shpallje të thirrjeve publike për shfrytëzuesit potencial të objekteve për sport. Komuna në periudhën e zbatimit të hulumtimit nuk gjeneron të ardhura nga dhënia e objekteve për sport, megjithëse ato janë në përdorim nga klubet e sportit.

Në **Komunën e Çairit** ekzistojnë katër objekte për sport edhe atë stadiumi i futbollit “Çair”, objekti sportiv me dedikimin për pishinë, salla sportive “Partizan” dhe salla sportive “Shaban Tërstena”.

Komuna në përgjigjen e saj të parë, ndaj informacioneve të kërkuara për objektet për sport të cilat ajo i ka në dispozicion, e ka cekur vetëm sallën sportive “Partizan” dhe sallën sportive “Shaban Tërstena”. Gjatë kësaj, komuna na informon që ajo vet si komunë menaxhon vetëm me sallën sportive “Partizan”, ndërsa për sallën sportive “Shaban Tërstena” kompetencat për menaxhim ia ka transferuar ndërmarrjes publike lokale të themeluar nga vetëqeverisja lokale, NP “Shkupi Vjetër”. Gjatë kësaj, të dy objektet janë jashtë përdorimit për shkak të dëmeve të shkaktuara nga zjarri që ka ndodhur në vitin 2011. Ndërsa, në anën tjetër, për sallën sportive “Shaban Tërstena” në rrjedhë është procedurë për legalizim, për shkak se nuk disponon me fletë pronësie.

Mirëpo, gjithashtu në procesin e hulumtimit kemi ardhur deri tek të dhënat që me Vendim të Qeverisë, të publikuar në Gazetën Zyrtare 07/2016, Komunës së Çairit i është dhënë për përdorim të përhershëm stadiumi i futbollit “Çair”,

ndërsa me Vendim të tillë të publikuar në Gazetën Zyrtare 175/2021, Komunës i është dhënë në përdorim të përhershëm edhe objekti sportiv me dedikimin për pishinë.

Komuna ka pohuar që stadiumi i futbollit "Çair" dhe objekti sportiv me dedikimin për pishinë janë fituar për përdorim të përhershëm, por me marrëveshje të lidhura aktive për përdorim, ndërmjet Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Objekte për Sport në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe subjekteve tjera juridike.

Nga komuna njoftojnë që, pas përfundimit të procedurës për legalizim të sallës sportive "Shaban Tërstena", do të miratohet procedurë me të cilën do të rregullohet procedura për dhënie në përdorim në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe se procedura do të shpallet për publikun.

NP "Parkinzi" Negotinë nuk shpall thirrje publike për dhënien e objekteve për përdorim, ndërsa nuk disponon as me procedurë të posaçme për përzgjedhjen e shfrytëzuesve të cilët i përdorin objektet për sport. Në periudhën e zbatimit të hulumtimit, objektet sportive nuk kanë qenë në përdorim as nga persona fizik e as nga persona juridikë.

Komuna e Negotinës ka dy objekte për sport, edhe atë Qendrën rekreative-sportive "Mlladost" dhe Stadiumin e qytetit. Këta dy objekte i janë dhënë nën menaxhim NP "Parkinzi" – Negotinë në periudhë të papërcaktuar dhe pa kompensim, me vendim të Këshillit të Komunës, të publikuar në Gazetën Zyrtare 12/2021. NP "Parkinzi", objektet sportive për përdorim ua jep vetëm sportistëve rekreativ me të cilët nuk nënshkruan marrëveshje dhe inkason mjete për secilin termin ndaras, pa termine të caktuara. Shuma e arkëtuar për një orë stërvitje është përcaktuar me listë tarifore dhe ajo lëviz nga 300 deri 450 denarë (varësisht nëse përdoret ndriçim ose jo) për një orë përdorimi të sallës së madhe, ndërsa nga 200 deri 300 denarë për një orë përdorim për sallën e vogël. Objektet sportive nuk përdoren nëse nuk ka termin të rezervuar nga ana e sportistëve rekreativ. Në periudhën e zbatimit të hulumtimit, asnjë nga klubet sportive nuk i përdor objektet.

MENAXHIM ME OBJEKTET PËR SPORT NGA ANA E SHKOLLAVE

- » Prej 124 objekteve për sport me të cilat disponojnë shkollat në vetëqeverisjet lokale të përfshira, në përdorim jepen vetëm 46, përkatësisht 36%. Gjatë kësaj, 40 shkolla të cilat i japin në përdorim objektet sportive e bëjnë atë pasi të marrin pëlqim nga vetëqeverisja lokale, mirëpo pa shpallje paraprake të thirrjes publike për të gjitha palët e interesuara, me përjashtim të dy shkollave (shkolla fillore "Strasho Pinxhur" dhe shkolla fillore "Goce Dellçev" në Negotinë). Specifik është rasti me vetëqeverisjen lokale të Shtipit, në të cilën, me objektet sportive të shkollave menaxhon komuna, e jo shkollat në mënyrë të pavarur.

Për dallim nga vetëqeverisjet lokale, të gjitha shkollat, të cilat i japin sallat dhe objektet e tyre sportive në përdorim arkëtojnë mjete për atë shërbim. Gjatë kësaj, është vërejtur dallim i madh në çmimet me të cilat objektet sportive jepen në përdorim nga ana e shkollave. Çmimet për përdorim të sallave sportive të shkollave lëvizin nga 200 denarë deri 1.300 denarë për një orë. Përgjithësisht, çmimet me të cilat shkollat i japin objektet e tyre në përdorim për klubet sportive dhe shoqatat e qytetarëve janë konsiderueshëm më të ulëta nga çmimet me të cilat këto objekte u jepen në përdorim personave fizik.

Komuna e Kumanovës ka 22 shkolla (17 shkolla fillore dhe 5 shkolla të mesme). Prej tyre, 18 shkolla kanë gjithsej 32 objekte për sport, nga të cilat 17 salla sportive, 6 terrene sportive, 7 hapësira për rekreacion, 1 poligon të vogël të jashtëm dhe një shteg për atletikë. Katër shkollat tjera nuk kanë asnjë objekt për sport.

Nga gjithsej 18 shkollat të cilat menaxhojnë me objekte sportive, katër shkolla ua japin ato në përdorim personave juridikë ose personave fizik. Këto shkolla kanë lidhur marrëveshje me gjithsej gjashtë klube sportive. Një shkollë nuk arkëton mjete nga tre klube sportive për përdorim të sallës, në bazë të kërkesës së Lidhjes për sporte për shkak të rinovimit të sallës së qytetit, të tjerat i japin në përdorim sallat e tyre me çmim nga 500 denarë deri 600 denarë për një orë stërvitje, ndërsa njëra shkollë ka lidhur marrëveshje për tërë vitin me shumë mujore prej 4.000 denarë.

Shkollat nuk shpallin thirrje për dhënien e sallave të tyre për përdorim, ndërsa vetëm 4 nga gjithsej 18 shkolla të cilat i japin në përdorim sallat e tyre kanë procedura të përcaktuara për mënyrën e dhënies në përdorim të objekteve të sportit.

Në Komunën e Kumanovës, prej 18 shkollave të cilat disponojnë me objekte sportive, vetëm 4 i japin ato në përdorim për personat juridikë ose personat fizik. Është vërejtur disproporcion i madh i çmimeve për dhënien në përdorim dhe mungesë e transparencës së procesit.

Në **Komunën e Tetovës** ka gjithsej 20 shkolla (13 shkolla fillore dhe 7 shkolla të mesme) të cilat disponojnë me gjithsej 11 salla sportive.

Nga gjithsej 10 shkolla të cilat kanë objekte për sport, vetëm pesë prej tyre i japin në përdorim sallat sportive. Gjatë hulumtimit, janë lidhur gjithsej 9 marrëveshje me klube sportive dhe me një person fizik.

Një shkollë nuk arkëton mjete, mirëpo sipas marrëveshjes, shfrytëzuesi duhet ta pajisë kabinetin për terapi fizikale me mjete të dukshme në lartësi prej 80.000 denarë. Shkollat tjera i japin në përdorim sallat me çmim nga 900 denarë deri 1.200 denarë për një orë stërvitje dhe arkëtojnë prej 1.000 denarë deri 2.000 denarë për ndeshje. Personave fizik u arkëtojnë nga 4.000 denarë në nivel mujor, ndërsa klubeve sportive prej 3.500 denarë e deri 12.000 denarë, varësisht nga shkolla. Shkollat të cilat i japin në përdorim sallat i kanë rregulloret e tyre dhe listat e çmimeve, mirëpo nuk shpallin thirrje për dhënien e sallave të tyre për përdorim.

Në Komunën e Tetovës, prej 13 shkollave të cilat kanë objekte sportive, vetëm 5 prej tyre ua japin personave juridikë dhe personave fizik të jashtëm. Janë vërejtur dallime të mëdha në çmimet për dhënie të këtyre objekteve në përdorim, si dhe mungesë e transparencës së procesit.

Komuna e Manastirit ka 19 shkolla (12 shkolla fillore dhe 7 shkolla të mesme) të cilat disponojnë me gjithsej 17 objekte për sport, nga të cilat 15 salla, 1 terren dhe 1 kuzhinë e cila përdoret për të luajtur ping-pong. Gjatë kësaj, 5 shkolla nuk kanë objekte sportive të cilat janë në pronësi të tyre ose me të cilat ato menaxhojnë.

Nga gjithsej 17 objekte për sport, lëndë e dhënies për përdorim janë 13 objekte. Për dhënien e tyre në përdorim, shkollat kanë lidhur 58 marrëveshje rrjedhëse, nga të cilat 29 marrëveshje janë lidhur me persona juridikë, 11 me persona fizik, ndërsa për 18 marrëveshjet tjera nuk ka informacion për palën kontraktuese për shkak se të dhënat në marrëveshjet e dërguara janë të mbuluara. Gjatë dhënies së këtyre objekteve në përdorim, shkollat i përmbahen listës së çmimeve për përdorim të sallave sportive në shkollat fillore dhe shkollat e mesme në rajonin e Komunës së Manastirit, me ç'rast, shkollat i japin në përdorim sallat me çmim prej 210 denarë deri 975 denarë, varësisht nga numri i termineve, periudha kohore kur jepen në përdorim dhe nëse bëhet fjalë për qëllime

rekreative ose për klube sportive. Në dy shkolla, objektet sportive të cilat janë në pronësi të shkollës ose janë dhënë nën menaxhimin e shkollave, momentalisht nuk jepen për përdorim për shkak të rinovimit.

Shkollat në Komunën e Manastirit i japin në përdorim objektet për sport pas pëlqimit të fituar nga vetëqeverisja lokale e Manastirit dhe nuk shpallin thirrje për dhënie në përdorim të objekteve për sport, të cilat janë në pronësi të tyre ose me të cilat ato menaxhojnë, por dhënia në përdorim zbatohet me kërkesë të shfrytëzuesve.

Komuna e Strumicës ka 12 shkolla (9 shkolla fillore dhe 3 shkolla të mesme). Këto shkolla disponojnë me gjithsej 16 objekte për sport, nga të cilat 10 salla sportive dhe 6 terrene sportive. Shtatë nga këto shkolla, krahas asaj që sallat e tyre sportive i përdorin nxënësit në orët e edukatës fizike, i japin në përdorim edhe për subjekte tjera të interesuara.

Këto shkolla kanë lidhur gjithsej 13 marrëveshje me klube sportive dhe dy me persona fizik. Gjatë kësaj, kur i japin në përdorim objektet e tyre për qëllime rekreative, për shërbimin ato arkëtojnë nga 1.500 denarë për një ditë ose 15.000 denarë në muaj, ndërkaq, për mbajtje të stërvitjeve në ndonjë nga sallat sportive të shkollave, klubeve sportive për 1 orë stërvitje u inkasojnë prej 250 denarë e deri 800 denarë, varësisht nga kushtet në shkollën konkrete, nga numri i stërvitjeve dhe ngjashëm. Shkollat dhe klubet nënshkruajnë marrëveshje, ndërsa mënyra e përlogaritjes është sipas listës së çmimeve të shkollës.

Në rajonin e Komunës së Strumicës, lëndë e dhënies në përdorim janë sallat sportive të 7 shkollave. Gjatë kësaj, për dhënien në përdorim të objekteve për sport nuk shpallen thirrje publike. Objektet për sport jepen në përdorim pas kërkesës paraprakisht të dorëzuar nga ana e klubeve ose personave fizik.

Komuna e Shtipit ka 11 shkolla (6 fillore dhe 5 shkolla të mesme) të cilat posedojnë gjithsej 19 objekte për sport, nga të cilat 11 salla sportive, 4 terrene ose 4 terrene në shkollat fillore dhe shkollat e mesme komunale. Sallat sportive në shkollat fillore dhe shkollat e mesme komunale trajtohen sikur janë në pronësi e Komunës dhe komuna është bartëse e së drejtës për ekonomizim me to. Së këtejmi, në marrëveshjet për dhënie në përdorim që lidhen me klube sportive, me shoqata të qytetarëve dhe me persona fizik me kërkesë për rekreacion, si nënshkrues të marrëveshjeve, nga njëra anë paraqiten Komuna e Shtipit dhe shkolla konkrete, ndërsa në anën tjetër, shfrytëzuesit e objektit. Procedura për dhënie në përdorim të terreneve sportive është e rregulluar sipas nenit 8 të Rregullores për përcaktimin e kushteve dhe mënyrës së përdorimit të terreneve sportive dhe objekteve sportive nga ana e Komunës së Shtipit nga 30 maj 2018, e cila ka pësuar ndryshime dhe plotësime më 14 mars 2022.

Sipas Rregullores në fjalë, për përdorim të terreneve sportive dhe objekteve sportive, subjektet e interesuara parashetrojnë kërkesë në Seksionin e shërbimeve publike të Komunës së Shtipit.

Shkollat i japin në përdorim sallat sportive të tyre me çmim prej 400 denarë deri 600 denarë për një orë për klubet sportive dhe për qëllime rekreative nga 800 deri 1200 denarë për një orë. Sallat sportive ndihmëse u jepen klubeve sportive me çmim prej 200 denarë për një orë.

Procesi i dhënies në përdorim të objekteve për sport në këtë komunë nuk është i shoqëruar me shpallje të thirrjeve publike.

Komuna e Kërçovës në territorin e saj ka gjithsej 11 shkolla (9 shkolla fillore dhe 2 shkolla të mesme). Nga 11 shkolla, vetëm 6 shkolla fillore kanë objekte për sport, edhe atë 11 gjithsej, nga të cilat 9 salla sportive, një hapësirë për rekreacion dhe një terren sportiv.

Komuna e Kërçovës ka rregullore në bazë të cilës shkollat i japin në përdorim objektet për sport. Me rregulloren përcaktohet mënyra e dhënies në përdorim të objekteve për sport në bazë të kërkesës së parashtruar nga ana e personave juridikë, nga shoqatat e qytetarëve, klubet sportive dhe nga persona tjerë juridikë. Mirëpo, shkolla e vetme që e jep në përdorim sallën e saj sportive, krahas asaj që e përdor atë për nevojat e nxënësve dhe për realizimin e procesit mësimor, në Komunën e Kërçovës është shkolla fillore "Dr. Vlladimir Polezhinovski". Momentalisht shkolla ka lidhur marrëveshje me një klub sportiv me çmim prej 9.000 denarë në nivel vjetor në pajtim me Rregulloren për dhënie në përdorim të sallës sportive. Shkolla nuk shpall thirrje për shkak se salla jepet në bazë të kërkesës paraprakisht të parashtruar nga ana e personave juridikë të interesuar.

Procesi i dhënies në përdorim është përcaktuar në Rregullore të miratuar nga ana e Komunës së Kërçovës, ndërsa ajo vlen për shkollat. Mirëpo, në Rregulloren nuk është paraparë obligim për transparencën e procesit të dhënies në përdorim të objekteve sportive të shkollave.

Komuna e Çairit ka 11 shkolla (10 shkolla fillore dhe 1 shkollë e mesme). Shkollat në pronësi të tyre kanë 12 objekte për sport, nga të cilët 8 salla sportive, 3 terrene sportive dhe një shkollë në pronësi të saj ka stadium sportiv.

Nga të gjitha shkollat, vetëm ShFK "Tefejjuz", përveç për nevojat e nxënësve, sallën shkollore pa kompensim e jep në përdorim për Klubin shkollor të sportit "Tefejjuz SPOR" – Shkup, Çair, me grupet (futboll, basketboll dhe projekte nga sporti shkollor), si dhe për Klubin e mundjes "Tefejjuz". Me shfrytëzuesit nuk janë nënshkruar marrëveshje. Shkolla nuk shpall thirrje dhe nuk ka procedurë të posaçme, por dhënia e sallës në përdorim bëhet në pajtim me Ligjin për arsim fillor në bashkëpunim me seksionin për arsim në Komunën e Çairit.

Në rajonin e Komunës së Çairit, lëndë e dhënies në përdorim është vetëm një objekt për sport në suaza të shkollave, edhe atë nga klubi sportiv i shkollës, për çka nuk paguhet kompensim. Shkollat nuk shpallin thirrje publike për dhënien në përdorim të objekteve për sport.

Në **Komunën e Negotinës** ekzistojnë 6 shkolla komunale, nga të cilat 4 janë shkolla fillore, njëra shkollë është shkollë e muzikës dhe një është shkollë e mesme. Shkollat disponojnë me 5 objekte për sport, nga të cilat 3 salla sportive dhe 2 terrene. Dy shkolla fillore të cilat gjenden jashtë qytetit – shkolla rajonale, nuk kanë objekte sportive, ndërsa objekt nuk ka as shkolla e muzikës.

Objektet sportive i japin në përdorim tre shkolla në Komunën e Negotinës dhe për ato kanë nënshkruar marrëveshje me 8 klube sportive, të cilat i përdorin për anëtarët e tyre, por edhe për individë të cilët merren me sport në mënyrë rekreative. Individët që merren me sport në mënyrë rekreative, të cilët nuk kanë lidhur marrëveshje me shkollat, u paguajnë shkollave kompensim nga 450 denarë deri 750 denarë për çdo stërvitje. Klubet tjera, stërvitjen prej një orë e gjysmë e paguajnë në shumë prej 285 denarë deri 450 denarë, ndërsa në mënyrë plotësuese, klubet paguajnë edhe nga 1.000 denarë për çdo ndeshje. Klubet të cilat e kanë në përdorim sallën me termine për tërë vitin paguajnë kompensim prej 5.000 denarë deri 12.000 denarë në nivel vjetor dhe nga 1.000 denarë shtesë për çdo ndeshje.

Shkollat fillore “Strasho Pinxhur” dhe “Goce Dellçev” janë shkollat e vetme nga të gjitha shkollat tjera të cilat ishin subjekt i monitorimit, ndërsa të cilat shpallin thirrje për dhënien në përdorim të sallave sportive, njëra shkollë në medium, kurse tjetra në ueb-faqen e vet.



REKOMANDIME

- ✓ Është e nevojshme që të gjitha komunat të miratojnë akte interne (procedurë, politikë ose ndonjë lloj dokumenti tjetër) me të cilat do të rregullohet procedura për menaxhim me objektet për sport, si dhe dhënia e tyre në përdorim. Mungesa e akteve interne në të cilat qartë do të saktësohet menaxhimi me objektet për sport flet për dobësi në menaxhimin me objektet, që padyshim edhe ka çuar deri në situatën në të cilën pjesë e konsiderueshme e objekteve sportive nuk janë funksionale, ndërsa pjesë e tyre, megjithëse janë funksionale, nuk përdoren.
- ✓ Komunitat duhet t'i japin në përdorim objektet për sport në bazë të procedurave transparente me shpallje paraprake të thirrjeve publike dhe me kushte, kritere dhe çmime qartë të përcaktuara. Në këtë mënyrë do të zvogëlohet mundësia për veprim vullnetar dhe për përdorim të parregulluar dhe joadekuat të objekteve për sport.
- ✓ Dhënia e objekteve në përdorim për klubet sportive pa kompensim financiar duhet të formalizohet në formë të ndonjë donacioni konkret ose ndonjë formë tjetër e përkrahjes pa kompensim.
- ✓ Duke mos e kontestuar të drejtën e komunave për dhënien e objekteve në përdorim për klubet profesionale të sportit, është e domosdoshme të ndërmerren masa për të siguruar qasje tek objektet edhe për profil shumë më të gjerë qytetarësh.
- ✓ Duke e pasur parasysh përpjekjen dhe kohën që ishin të nevojshme për t'i siguruar të dhënat për objektet për sport dhe për përdorimin e tyre, është e nevojshme që në të ardhmen, komunat ta avancojnë llogaridhënien në lidhje me atë se kush i përdor objektet për sport dhe me çfarë kushte. Në këtë mënyrë, qytetarëve do t'u mundësohet këqyrje e plotë në këtë gjendje dhe do të zvogëlohet hapësira për dyshim dhe për keqpërdorime.
- ✓ Sa u përket shkollave, imponohet nevoja për miratim të akteve të unifikuara interne me të cilat do të rregullohet procesi dhe kushtet e dhënies në përdorim të objekteve për sport në nivel të një komune konkrete.
- ✓ Dallimet e mëdha në çmimet me të cilat jepen në përdorim objektet sportive të shkollave, ndërsa të cilat mund të vërehen jo vetëm ndërmjet komunave por edhe në kuadër të vetë komunave, e imponojnë nevojën për harmonizim me qëllim që të shmangët rreziku që shfrytëzues të caktuar të kenë pozitë të favorizuar në raport me shfrytëzues të tjerë.

ANEKSI 1: Lista e objekteve për sport me të cilët disponojnë komunitat e monitoruara

KOMUNA E KUMANOVËS

1. Kompleksi Pishinë e çelur dhe e mbyllur e qytetit – funksionon dhe me atë menaxhon NP “Kumanovo Parking”
2. Stadiumi i Qytetit – funksionon dhe me atë menaxhon NP “Kumanovo Parking”
3. Terrenet e tenisit në Shtegun e Qytetit – funksionon dhe me atë menaxhon NP “Kumanovo Parking”
4. Terrenet e tenisit “23 Oktomvri” funksionojnë dhe me ato menaxhon NP “Kumanovo Parking”
5. Qendra Sportive – Salla sportive – nuk është në funksion
6. Kompleksi sportiv “Sokollana” – nuk është në funksion
7. Kompleksi “Poligoni urban i qitjes” – nuk është në funksion
8. Qendra sportive dhe rekreative “Pelince” – nuk është në funksion

KOMUNA E TETOVËS

1. Stadiumi i futbollit me bar artificial pranë qendrës sportive – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
2. Pishina e qytetit - funksionon dhe me atë menaxhon komuna
3. Stadiumi kryesor i qytetit – i është dhënë nën koncesion një firme private
4. Stadiumi ndihmës pranë stadiumit kryesor – i është dhënë nën koncesion një firme private
5. Stadiumi në lagjen Teqe – funksionon dhe u është dhënë në dispozicion banorëve lokal
6. Stadiumi në fshatin Reçica e Madhe – funksionon dhe u është dhënë në dispozicion banorëve lokal
7. Stadiumi në fshatin Saraqinë – funksionon dhe u është dhënë në dispozicion banorëve lokal

KOMUNA E MANASTIRIT

1. Salla sportive “Boro Çurlevski” Manastir – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
2. Stadiumi i futbollit “Petar Milloshevski” Manastir – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
3. Pishinë e çelur – i është dhënë komunës në përdorim të përhershëm, por me kontrata rrjedhëse për përdorim nga ana e personave të tjerë juridikë paraprakisht të nënshkruara me Ndërmarrjen publike për Ekonomizim me Objekte Sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut
4. Terrene për tenis - i janë dhënë komunës në përdorim të përhershëm, por me kontrata rrjedhëse për përdorim nga ana e personave të tjerë juridikë paraprakisht të nënshkruara me Ndërmarrjen publike për Ekonomizim me Objekte Sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut
5. Terrene hendbolli - i janë dhënë komunës në përdorim të përhershëm, por me kontrata rrjedhëse për përdorim nga ana e personave të tjerë juridikë paraprakisht të nënshkruara me Ndërmarrjen publike për Ekonomizim me Objekte Sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut
6. ShEF “Partizan” – i është dhënë komunës në përdorim të përhershëm, por me kontrata rrjedhëse për përdorim nga ana e personave të tjerë juridikë paraprakisht të nënshkruara me Ndërmarrjen publike për Ekonomizim me Objekte Sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut

KOMUNA E KËRÇOVËS

1. Salla sportive "Hristo Uzunov" Ivanidoll – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
2. Salla sportive "Sokollana" – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
3. Salla sportive "Jançica" – nuk është në funksion, është duke u rinovuar dhe me atë menaxhon komuna.
4. Stadiumi i qytetit – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
5. Stadiumi "Vëllazërimi" – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
6. Stadiumi në Zajas – funksionon dhe me atë menaxhon komuna

KOMUNA E STRUMICËS

1. Fusha komunale e futbollit "Filip Lazarevski" – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
2. Stadiumi QS (Gradsko Balldovci) – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
3. Stadiumi "Mladost" / "Blagoj Istatov" (i është dhënë në menaxhim Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Objekte për Sport në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut)
4. Salla sportive "Parku" (i është dhënë në menaxhim Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Objekte për Sport në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut)
5. Salla sportive "Partizan" (i është dhënë në menaxhim Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Objekte për Sport në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut)

KOMUNA E SHITIPIT

1. Fushë e futbollit në Bello Bërdo – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
2. Fushë e futbollit në Suitlak – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
3. Terreni sportiv me shumë dedikime në BU Autokomandë – funksionon dhe me atë menaxhon komuna
4. Terreni sportiv me shumë dedikime në BU Senjak – funksionon dhe me atë menaxhon komuna

KOMUNA E ÇAIRIT

1. Salla sportive "Partizan" – nuk është në funksion, përndryshe me të menaxhon NP "Shkupi i Vjetër"
2. Salla sportive "Shaban Tërstena" - nuk është në funksion, përndryshe me të menaxhon NP "Shkupi i Vjetër"
3. Stadiumi i futbollit "Çair" – i është dhënë komunës në përdorim të përhershëm, por me kontrata rrjedhëse për përdorim nga ana e personave të tjerë juridikë paraprakisht të nënshkuara me Ndërmarrjen Publike për Ekonomizim me Objekte Sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut
4. Objekti sportiv me dedikimin për pishinë – i është dhënë komunës në përdorim të përhershëm, por me kontrata rrjedhëse për përdorim nga ana e personave të tjerë juridikë paraprakisht të nënshkuara me Ndërmarrjen Publike për Ekonomizim me Objekte Sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut

KOMUNA E NEGOTINËS

1. SRC Mladost – funksionon dhe me atë menaxhon NP "Parkinzi" – Negotinë
2. Stadiumi i qytetit të Negotinës – funksionon dhe me atë menaxhon NP "Parkinzi" – Negotinë



 Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации
